



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DORIANA A. PELLUMBI
ADRESA NR.5, JANOS HYNVADI
TEL: 676359087

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 137

Tirane më 15/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



V2021051070006378632

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER DORIANA A. PELLUMBI



DATE 15/02/2021
NR REP 137

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15.02.2021, para meje Notere DORIANA A. PELLUMBI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, JANOS HYNVADI, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Emi Canaj, atësia Mitat, amësia Etleva, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Vaso Pasha; Nd. 15; H. 26; Ap. 5; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 1019; Tiranë, lindur më 18/06/1991, gjendja civile "e divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035542575 dhe nr. personal J15618050C , .

DEKLARUES/IT:

Ermira Muça, atësia Shefqet, amësia Pranvera, shtetase Shqiptare, lindur në Vorë, Tiranë dhe banues në Vorë, me adresë Rruge Panjohur; Vorë; 0000; Vorë, lindur më 02/05/1993, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 027715505 dhe nr. personal J35502082E ,

Palet e mesiperme në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje akt themelimin dhe statutin e shoqërisë "E Progress SH.P.K "

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
DORIANA A. PELLUMBI

STATUTII
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ E Progress SH.P.K “

I. THEMELIMI

Neni 1
Preambula

Themelueset ” E Progress SH.P.K kanë hartuar dhe miratuar këtë Statut në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në veçanti me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të këtij Ligji, ku rregullohen hollësisht çështjet e organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, kjo në përputhje me ligjin shqiptar dhe çdo legjislacion të mëvonshëm të zbatueshëm.

Neni 2
Ortakët

Ortakët e Shoqërisë janë Znj, Ermira Muça Znj. Emi Canaj (në vijim referuar si “Ortakët”).

Kontributet e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë janë në para. Kontributet e Ortakëve në para do të jetë 100.000 mijë lekë .

Ortakët kanë derdhur kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë, me qëllim që të përfitojnë të ardhura që burojnë nga veprimtaria e Shoqërisë, duke mos u përgjigjur për detyrimet e Shoqërisë, por duke mbuluar personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Për mënjanimin e çdo dyshimi, Ortakët gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tyre në kapitalin e përfaqësuar në pjesë kapitali.

II. EMËRTIMI- SELIA-FORMA LIGJORE-OBJEKTI

Neni 3
Emërtimi

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është shoqëria tregtare E Progress SH.P.K

Neni 4
Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Ish Kombinati Metalurgjik Elbasan Shqipëri.



Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me miratim paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5 Forma Ligjore

Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), në përputhje me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 6 Baza Ligjore

Shoqëria, “E Progress SH.P.K.” do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare (Corporate Governance Code), siç është miratuar me vendimin nr. 1, datë 02.12.2011 të Këshillit Konsultativ të Biznesit, të gjitha dispozitat e tjera të detyrueshme në bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 7 Emblema dhe Vula

Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Administratorët Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

Neni 8 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:

Shoqëria “E Progress SH.P.K.” do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj Import, eksport, tregti të artikujve të ndryshëm, tregti me pakicë të karburanteve, lëndëve djegëse, servis automjetesh, transport mallrash, veprimtari në fushën e turizmit, Bar - Restorant, Hoteleri, tregti me pakicë të artikujve ushqimorë dhe industrial. Blerje, import-eksport, transport edhe për llogari të tretëve, shperndarje me shumicë të lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike duke përfshirë dhe bitumet. Blerje, shitje, qiradhënie, ndërtim dhe administrim të impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme. Import-eksport, grumbullim, depozitim, përpunim, riciklim të mbeturinave të çfarëdo lloji materiali të



lejuara për t'u importuar në territorin shqiptar. Grumbullim, transportim, ruajtje, magazinim, rikuperim, riciklim dhe asgjësim të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të llojeve të ndryshme që gjenerohen brenda territorit të Shqipërisë. Transport i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me mjete teknologjike nga gjeneruesi i tyre drejt impianteve të trajtimit të mbetjeve. Ruajtja dhe magazinimi i përkohshëm i mbetjeve të llojeve të ndryshme industriale me qëllim rikuperimin, riciklimin dhe ripërdorimin e tyre si lëndë e parë dytësore në industrinë përkatëse. Ndërtim linjash industriale për përpunim dhe riciklim mbetjesh. Import makinerish dhe pjesë këmbimi që kanë lidhje me impiantet industriale të përpunimit të mbetjeve, import makinerish dhe pjesë këmbimi të ndryshme, Ndërtime në fushën e ndërtimit punime dheu, beton, punime shembjesh, ndërtime civile, industriale, turistike, punime restaurime, transport brenda dhe jashtë vendit etj.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet ekonomik dhe joekonomik që lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka të bëjë me objektivat/veprimtaritë e renditura sa më lart. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të ndërmarrë aktivitet tregtar, financiar, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet dhe përmbushë objekti i Shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të ngushtohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

III. KOHËZGJATJA

Neni 9 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pakufizuar. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë kufizim kohor në jetëgjatësinë e Shoqërisë.

IV. KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 10 Kapitali


Kapitali fillestar i Shoqërisë është në para.

Ky kapital është tërësisht i shlyer nga Ortaket, përpara regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar.

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 100 000 (njëqindmijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota

Znj.Emi Canaj zotëron një kuotë me vlerë nominale 67 000 (gjashtëdhjetë shtatë mijë) lekë, që përfaqëson 67 (gjashtëdhjetëeshtatë) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Znj.Ermira Muca zotëron një kuotë me vlerë nominale 33 000 (tridhjetëetë) mijë



lekë, që përfaqëson 33 (tridhjetëetrepërqind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar në para janë shlyer me para dhe janë paguar plotësisht përpara nënshkrimit nga Ortakët. Nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve të mëtejshme të kapitalit mund të bëhet me para ose me kontribute në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 11

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial.

Pjesët e kapitalit transferohen automatikisht në rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve të Shoqërisë, si dhe shoqërive të kontrolluara prej tyre, në rast se ka të tilla.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'i transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, kjo vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar.

Çdo transferim i kapitalit themeltar bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

E drejta e parablerjes

Transferimi për çfarëdo arsye, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomandë (lajmërim marrje), i cili përmban çmimin, blerësin e mundshëm dhe mënyrën e pagesës.

Në rast se ortaku i cili mban të drejtën e parablerjes nuk përgjigjet brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor të lartpërmendur, atëherë konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes së pjesëve të kapitalit që do të tjetërsohen.

Neni 13

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para apo në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Ortakët mund të rrisin pjesën e tyre në kontributin e kapitalit themeltar vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrjen e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit të Shoqërisë.



Zmadhimi i kapitalit i realizuar nga njëri prej ortakëve nuk i detyron ortakët e tjerë të rrisin edhe ata pjesën e tyre.

Vendimi i zmadhimit të kapitalit themeltar mund të sjellë edhe riorganizimin e numrit dhe vlerës së secilës pjesë të tij dhe zotërimin e tyre nga ortakët.

Rritja e kapitalit themeltar mund të realizohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen si të tillë me vendim të Ortakut në të njëjtën mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme që miraton zmadhimin e kapitalit themeltar.

Neni 14 Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet ekskluzivisht me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kapitali themeltar nuk mund të jetë më i vogël sesa minimumi i përcaktuar me ligj, 100 000 (njëqind mijë) Lekë, përndryshe Shoqëria është e detyruar që të ndryshojë formën e saj juridike apo të shpërbëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Zvogëlimi i kapitalit miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me Ortak të vetëm, apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me pjesëmarrje të ortakëve që përfaqësojnë $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

V. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- dhe
- Administratori

Neni 15 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortakët e Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:



- ndryshimin e Statutit;
- përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- likuidimin e Shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e administratorit të Shoqërisë, likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë ;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë për ushtrimin e të gjitha tagrave të dhëna nga dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në veçanti për mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87, pika 1, të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme (nëse në të ardhmen ekzistojnë më shumë se një ortak), merren me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të Ortakëve pjesëmarrës, të thirrur sipas Nenit 86, pika 1, të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet e tjera të renditura në Nenin 81 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme (nëse ekzistojnë më shumë se një ortak), merren me shumicën e votave (tetedhete perqind) të Ortakëve të pranishëm me të drejtë vote (Ortakëve pjesëmarrës).

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme me Ortak të vetëm, për çështjet që parashikon neni 87, pika 1, i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” do të njësohen me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të një Asambleje të Përgjithshme me dy ose më shumë ortakë dhe për çështjet e tjera që parashikon neni 81 i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme me Ortak të vetëm do të njësohen me shumicën e votave të një Asambleje të Përgjithshme me dy ose më shumë ortakë.



Të gjithë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme me Ortak të vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: (i) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; (ii) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; (iii) investime; (iv) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Kjo pavlefshmëri nuk mund t'i kundrejtohet të tretëve që kanë fituar të drejta në mirëbesim nga Shoqëria, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, ose kur provon se, duke u bazuar në rrethanat e veçanta, i treti nuk mund të mos kish patur dijeni për pavlefshmërinë.

Neni 16

Thirrja dhe Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Mënyra e thirrjes, mbledhja dhe regjistrimi i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhen në përputhje me dispozitat e neneve 81, 82 dhe 83 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë orën, datën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Lajmërimi bëhet nga Administratori i Shoqërisë. Njoftimi do të dërgohet në adresën që rezulton në Librin e Shoqërisë.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas specifikimeve të mësipërme, atëherë Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët bien dakort për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Mbledhja e Asamblesë mund të bëhet edhe sipas rregullave procedurale të mbledhjes të miratuara nga vetë Asambleja e Përgjithshme.

Neni 17

Administratori

Shoqëria administrohet nga nje ose me shume Administratorë emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Numri i administratorëve mund të ndryshohet sa herë që Asambleja e Përgjithshme e gjykon të arsyeshme. Administratori mund të jetë i çdo kombësie dhe emërohet për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë riemërimi.



Në rast dorëheqjeje, pushimi nga puna apo skualifikimi të ndonjë Administratori, pasardhësi që do të zërë vendin e Administratorit do të zgjidhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, menjëherë pas kësaj ngjarjeje, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë që nëpërmjet një vendimi të marrë me shkrim, të përfundojë para afatit mandatin e njërit ose të gjithë Administratorëve, pa pasur nevojën dhe detyrimin të shtrojë arsye të motivuar për këtë shkarkim.

Pas pranimit të emërimit, Administratorët do të deklarojnë me shkrim që marrëdhënia e tyre me Shoqërinë është ngritur mbi baza besimi. Në këtë kontekst, vendimi për t'i shkarkuar Administratorët me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të pamotivuar, gjykohet si një arsye legjitime për heqjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Shoqëria mund të përfaqësohet nga 1 (një) Administrator edhe në qoftë se do të emërohen më shumë se 1 (një) Administratorë, ose nga të gjithë Administratorët e emëruar.

Administratorit i janë dhënë të gjitha tagrat për të vepruar, me qëllim për të krijuar marrëdhënie me palët e treta për interes të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, përveç kur këto tagra kufizohen në përgjithësi nga ligji dhe përveç atyre të cilat në menyrë të shprehur u përkasin Asamblesë së Përgjithshme me ligj, akte të Shoqërisë, ose kanë një rëndësi të tillë për të cilat miratimi i Asamblesë së Përgjithshme është i domosdoshëm. Këto kufizime tagrash të Administratorit (ëve) i kundrejtohen palëve të treta.

Aktiviteti i përditshëm i Shoqërisë kryhet nga Administratori (Administratorët) duke përfaqësuar apo vepruar në emër të Shoqërisë me palët e treta, institucionet publike apo private, duke hyrë në marrëveshje si dhe duke përfaqësuar Shoqërinë përballë gjykatave të shkallëve të ndryshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Kompetencat e Administratorit (Administratorëve) që përfaqëson/përfaqësojnë Shoqërinë për këtë qëllim përfshijnë:

- Të veprojë dhe nënshkruajë në emër të Shoqërisë; të punësojë apo të shkarkojë punonjësit e Shoqërisë; të hartojë rregulloret e brendshme të Shoqërisë;
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Të përfaqësojë Shoqërinë;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;



- Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, eventualisht bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Të mbajë një regjistër ku të regjistrohen emri i plotë i ortakëve, emri i Shoqërisë, vendbanimi apo selia e ortakëve, përqindja përkatëse e interesit në kapitalin themeltar të Shoqërisë, transferimi i kuotave apo çdo ndryshim i të dhënave të mësipërme;
- Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në lidhje me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi thelbësore për veprimtarinë e Shoqërisë;
- Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë që e detyron ligji si dhe për marrjen e vendimeve që duhet miratimi i saj;
- Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut, pa ndërhyrë kurrësesi në kompetencat që me ligj apo Statut i janë dhënë Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme, në rast të shtimit të numrit të Administratorëve, mund të miratojë një vendim për t'u dhënë të gjithë Administratorëve kompetencë të përbashkët përfaqësimi.

Çdo Administrator, në kryerjen e aktiviteteve të tij përkatëse, duhet të jetë në konformitet me ligjin, rregullat e drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe procedurave për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Administrator do të drejtojë aktivitetin e Shoqërisë dhe do të sigurojë zbatimin e të gjithë urdhrave dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo Administrator do të kryejë edhe detyra të tjera siç mund të parashtrihen nga Asambleja e Përgjithshme, dhe gjatë drejtimit normal të aktivitetit, mund të delegojë një pjesë të kompetencave dhe të të drejtave të tij përkatëse tek një ose disa zyrtarë të Shoqërisë, në përputhje me rregullat e procedurës së drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe me procedurën për vendimet e drejtimit, të miratuara me ~~vendim~~ të

Asamblesë së Përgjithshme.

Aktet dhe masat që tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të aktivitetit të Shoqërisë janë objekt i miratimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori (Administratorët) është/janë përgjegjës përkundrejt Shoqërisë dhe çdo personi të tretë për çdo shkelje të ligjit apo akteve të Shoqërisë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Shoqëri, siç parashikohet në dispozitat e Nenit 98 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Administratori mban individualisht përgjegjësi përballë Shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e mundshme të ligjit dhe/ose të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, votë e marrë kjo me shumicë të zakonshme. Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të autoriteteve gjyqësore shqiptare për shkelje të ligjit.

Paga e Administratorit si dhe shpërblime të tjera përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme.

VI. VITI FINANCIAR-LIKUIDIMI

Neni 18 Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më datë 1 Janar dhe duke mbaruar më datë 31 Dhjetor.

Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë pranë organeve tatimore dhe përfundon më datë 31 Dhjetor.

Neni 19 Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

Administratori do të mbajë llogari financiare të përshtatshme dhe do të përgatisë raporte financiare për të pasqyruar me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë, në përputhje me parimet e kontabilitetit. Llogaritë dhe raportet financiare do të jenë në formë dhe përmbajtje në përputhje me standartet e kontabilitetit, sipas parashikimeve ligjore.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën Shqipe dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë.

Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore.

Shoqëria mund të marrë financime nga Ortakët ose nga ortakët i vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak), nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim Shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 20 Ekspertët kontabël të autorizuar

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë të paktën një ekspert kontabël të jashtëm të pavarur, i cili do të jetë një ekspert kontabël i autorizuar (në vijim referuar si “**Eksperti Kontabël i Autorizuar**”). Eksperti Kontabël i Autorizuar do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të kontrollojë llogaritë e Shoqërisë, regjistrimet e veprimeve dhe transaksioneve të saj;
- Të vërtetojë, në përputhje me rregulloret përkatëse, raportin vjetor mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë (bilancin, pasqyrat financiare të humbjeve dhe fitimeve dhe raporte të tjera që lidhen me to) dhe të japë mendimin e tij nëse pasqyrat financiare pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë;
- Të informojë Administratorin(ët) dhe Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë për çdo parregullsi apo mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve apo llogarive të Shoqërisë të cilat mund të rezultojnë në humbje të konsiderueshme për Shoqërinë;
- Të rishikojë përshtatshmërinë e praktikave dhe procedurave të auditimeve dhe kontrolleve të brendshme dhe, nëse është me vend, të japë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Të kryejë të gjitha detyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” siç mund të ndryshojë kohë pas kohe.

Neni 21 Të ardhurat. Dividendi

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve dhe tarifave që i cakton vetë Shoqëria.



Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, të deklaruar në pasyrat financiare të Shoqërisë, pas pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera të privilegjuara, mund t'i shpërndahen Ortakut të vetëm ose mund t'i shpërndahen Ortakëve (në rast se ekzistojnë dy ose më shumë ortakë). Shpërndarja e fitimeve (dividendit) do të bëhet në raport me pjesët/kuotën që Ortakët zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë.

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur ose shtuar shumat respektive të humbjeve apo fitimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Humbjet e Shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo Ortaku i vetëm ose çdo ortak (në rast se ekzistojnë dy ose më shumë ortakë), do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Neni 22 Shkaqet e prishjes së Shoqërisë

Shoqëria prishet :

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- me vendim të gjykatës.

Neni 23 Likuidimi

Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të prishë Shoqërinë si dhe për çdo shkak tjetër të përcaktuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në mënyrë që të ndërmarrë procedurat e likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator ose një grup likuidatorësh. Nëse ky vendim nuk do të merret, atëherë çdo person i interesuar, brenda 30 ditëve pas prishjes, mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidator.

Në rastet kur Shoqëria prishet me vendim gjykate, likuidatori emërohet nga gjykata.

Administratori njofton për rregjistrim në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit, të



dhënat e likuidatorit.

Detyra e likuidatorit është mbyllja e të gjithë veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të Shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit në përputhje me Kodin Civil. Likuidatori do të raportojë mbi gjendjen e zërave të aktivitetit dhe të pasivitetit të Shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Përgjithshme shqyrton bilancin përfundimtar të përgatitur nga likuidatori dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

Në fund të procedurës së likuidimit dhe në rast se të gjithë kreditorët e Shoqërisë janë paguar dhe kështu Shoqëria i ka shlyer të gjithë detyrimet, kapitali i mbetur i kthehet Ortakut të vetëm ose ortakëve (në rast se ekzistojnë më shumë se një ortak), kjo në përputhje me pjesët e zotëruara në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 24 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin përgjatë veprimtarisë së Shoqërisë, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor në juridiksionin e së cilës përket mosmarrëveshja.

Neni 25 **Ligji i Zbatueshëm**

Të gjitha çështjet që nuk trajtohen nga ky Statut në mënyrë të veçantë, do të trajtohen dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 26 **Pavlefshmëria**

Në rast se ndonjë nga dispozitat e këtij Statuti do të jetë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, atëherë dispozita në fjalë nuk do të konsiderohet juridikisht, ndërkohë që të gjitha dispozitat dhe nenet e tjerë të këtij Statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshëm.

Pavlefshmëria e themelimit të Shoqërisë trajtohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



Neni 27
Dispozita Përfundimtare


Ky Statut hynë në fuqi menjëherë pasi është nënshkruar nga Ortakët.

Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe, secila me të njëjtën vlerë juridike.

Ky Statut nënshkruhet sot në Tiranë, më datë 15.02.2021

ORTAKET E SHOQËRISË
E Progress SH.P.K

Znj.Emi Canaj


Emi Canaj

Znj.Ermira Muça


Ermira Muça


NOTERE
DORLANA PELLUMBI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERE DORIANA PËLLUMBI
DHOMA E NOTËRISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ kōl



AKT – THEMELIMI

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ E Progress SH.P.K “**

Sot në Tiranë, më datë 15.02.2021, hartuan dhe nënshkruan këtë akt-themelimi (në vijim referuar si “*Akti i Themelimit*”), palët e mëposhtme:

Znj. Ermira Muça, e datëlindjes 2.05.1993 lindur në Vorë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet meje noteres me anë të pasaportës me nr.personal J35502082E

Znj.Emi Canaj, e datëlindjes 18.06.1991 lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet meje noteres me anë të pasaportës me nr.personal J15618050C

PREAMBULA

Duke marrë në konsideratë se Themelueset kërkon të ushtrajnë veprimtari ekonomike dhe ka për qëllim arritjen e objektivave ekonomike, duke dhënë dhe injektuar kontributet në një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me qëllimin final për të prodhuar përfitim ekonomik. Themelueset me qëllim për të deklaruar themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare, me emrin “**E Progress SH.P.K** “

Atëherë, duke marrë në konsideratë sa më lart, Themelueset janë dakort me hartimin e këtij Akti-Themelimi dhe me përmbajtjen e tij.

ATËHERË, duke marrë në konsideratë sa më lart, për të cilat Themelueset janë dakort dhe nuk kanë pretendime, Themelueset bien dakort për hartimin dhe përmbajtjen e këtij Akti-Themelimi si më poshtë.



Neni 1
Forma - Emri – Selia

Shoqëria tregtare do të jetë e formës *shoqëri me përgjegjësi të kufizuar* dhe do të ketë emrin “ **E Progress SH.P.K** “

Shoqëria “ **E Progress SH.P.K** “ SH.P.K do të ketë selinë e saj në adresën, Rruga ish Kombinati Metarlugjik në Elbasan, Shqipëri. Adresa e selisë së shoqërisë do të përcaktohet edhe në statutin e saj dhe mund të ndryshojë në të ardhmen me vendim të organeve vendimmarrëse përkatëse.

Neni 2
Parimet – Kohëzgjatja

2.1 Shoqëria **E Progress SH.P.K** “ do të jetë dhe do të funksionojë si një shoqëri tregtare, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e pavarur nga Shteti dhe nga institucionet e Shtetit shqiptar dhe/ose partitë politike, si dhe e pavarur nga çdo organizatë apo organizëm tjetër i së drejtës publike apo private.

2.2 Shoqëria “ **E Progress SH.P.K** “ do të punojë bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë, efektive dhe të ndershme. Funksionimi i shoqërisë “**E Progress SH.P.K** “ do të funksionojë bazuar në parimin e detyrimit të besnikërisë, në parimin e të drejtës së informimit, në parimin e ndalimit të abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë, në parimin e ndalimit të konkurrencës së pandershme, në parimin e sekretit tregtar, siç rezultojnë nga dispozitat 14 deri 18 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në çdo parim tjetër që komandohet nga zakonet dhe marrëdhëniet e mira tregtare, si dhe në Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare (Corporate Governance Code), siç është miratuar me vendimin nr. 1, datë 02.12.2011 të Këshillit Konsultativ të Biznesit.

2.3 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “**E Progress SH.P.K** “ do të jetë pa afat të përcaktuar.

2.4 Veprimtaria e shoqërisë **E Progress SH.P.K** “ do të bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe/ose marrëveshjet ndërkombëtare që do të ratifikohen në të ardhmen, legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në veçanti atë për shoqëritë tregtare, në Statutin dhe Akt-Themelimin e saj.



2.5 Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, Themelueset të 2 Ortakët dhe , Administratori si dhe punonjësit e shoqërisë **E Progress SH.P.K** nuk përgjigjen individualisht/personalisht apo solidarisht për detyrimet e kësaj të fundit ndaj personave të tretë (persona fizikë apo persona juridikë), por mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

2.6 Themelueset do të japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të parashikuara në statutin e shoqërisë, si dhe do të kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe të dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria “**E Progress SH.P.K**” do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj Import, eksport, tregti të artikujve të ndryshëm, tregti me pakicë të karburanteve, lëndëve djegëse, servis automjetesh, transport mallrash, veprimtari në fushën e turizmit, Bar - Restorant, Hoteleri, tregti me pakicë të artikujve ushqimorë dhe industrial. Blerje, import-eksport, transport edhe për llogari të të tretëve, shpërndarje me shumicë të lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike duke përfshirë dhe bitumet. Blerje, shitje, qiradhënie, ndërtim dhe administrim të impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtëshme. Import-eksport, grumbullim, depozitim, përpunim, riciklim të mbeturinave të çfarëdo lloj materiali të lejuara për t’u importuar në territorin shqiptar. Grumbullim, transportim, ruajtje, magazinim, rikuperim, riciklim dhe asgjësim të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të llojeve të ndryshme që gjenerohen brenda territorit të Shqipërisë. Transport I mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me mjete teknologjike nga gjeneruesi I tyre drejt impianteve të trajtimit të mbetjeve. Ruajtja dhe magazinimi I përkohshëm I mbetjeve të llojeve të ndryshme industriale me qëllim rikuperimin, riciklimin dhe ripërdorimin e tyre si lëndë e parë dytësore në industrinë përkatëse. Ndërtim linjash industriale për përpunim dhe riciklim mbetjesh. Import makinerish dhe pjesë këmbimi që kanë lidhje me impiantet industriale të përpunimit të mbetjeve, import makinerish dhe pjesë këmbimi të ndryshme. Ndërtime në fushën e ndërtimit punime dheu, beton, punime shembjesh, ndërtime civile, industriale, turistike, punime restaurime, transport brenda dhe jashtë vendit etj.



Neni 4
Kapitali - Përfaqësimi - Organet e Shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë kapitalin të përcaktuar në statutin e saj, sipas kontributeve të Themeluesve të saj në para dhe/ose në natyrë. Kapitali fillestar i shoqërisë do të jetë 100.000(njëqind mijë) lekë.

4.2 Shoqëria “E Progress SH.P.K” do të përfaqësohet sipas rregullave të përcaktuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe sipas rregullave të statudit.

4.3 Rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë parashikohet në statutin e saj, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Bërë në Tiranë, më datë 15.02.2021 në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe secila me të njëjtën vlerë juridike.

THEMELUESËT E SHOQËRISË
E Progress SH.P.K

Znj. Znj. Ermira Muça

Ermira Muça


Znj. Emi Canaj

Emi Canaj

Emi Canaj

NOTERE

DORIANA PELLUMBI

